



Prishtinë, 24 Qershor 2014

Kodi i ZRRE: V\_634\_2014

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimi i ZRRE-së nr. V\_517\_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Aplikacionin e KEDS-OSSH-së të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE8) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më **24 Qershor 2014** nxori këtë:

## VENDIM

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për vitin relevant tarifor apo SHTE8 (2014-2015), i cili fillon nga 1 prilli 2014.

## ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KEDS aplikacionin e OSSH-së për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale, që duhet mbledhur nga OSSH-ja përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes (DUOS).
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR, që do të mbulohet nga OSSH, ZRRE ka marrë parasysht dokumentet si në vijim, që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
  - Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Gjatë periudhës shkurt-maj 2014 janë mbajtur takime dhe konsultime për të sqaruar aplikacionin e të licencuarve;




- Raport përfundimtar- Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Qershor 2014; dhe
  - Raport përfundimtar - Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar më datën 24 Qershor 2014.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OSSH-ja për vitin relevant tarifar SHTE8 (2014-2015) janë 63,892,120 euro. Vlerësimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale janë të paraqitura në Raportet përfundimtarë për OSSH-në dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH të paraqitura më lartë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes.
- IV. Mbajtësi i licencës për OSSH duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes (DUOS) të përcaktuar me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurtër.
- V. Ngarkesat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të aprovuar nga ZRRE.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE**

  
Enver Halimi, Kryesues

  
Merita Kostari, Anëtar

  
Krenar Bujupi, Anëtar